



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	64757/25
Nr. i fq. / Br. sf	- 8 -
Data: / Datum	26. 12. 25
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

**Procesverbali nga takimi i dytë publik me qytetarët i Kryetarit të Komunës së Vushtrrië
për punën një vjeçare Janar - Dhjetor 2025**

Dhjetor, 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i dytë publik me qytetarët i kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për punën një vjeçare Janar – Dhjetor 2025.

Datë: 26.12.2025

Ora: 11:00

Vendi: Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën një vjeçare (Janar - Dhjetor 2025) të ekzekutivit.

Të pranishëm kanë qenë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive.

Feriti Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, falënderoi qytetarët pjesëmarrës në takim dhe tha se këto takime janë shumë të rëndësishme për faktin se qytetarët i shprehin edhe brengat edhe vërejtjet për punët tona.

Nuk kam dëshirë që çdo gjë që kemi punuar ta merr notën maksimale sepse e di që kemi edhe ngecje gjatë procesit, përkundër që janë bërë punë shumë të mira për qytetin e Vushtrrisë.

Unë do ti referoj shkurtimisht punët dhe projektet e realizuara gjatë këtij viti. Do të fillojmë nga fusha e arsimit çka është bërë gjatë gjithë vitit. Fillimisht dua të ju njoftoj se më të vërtetë e kemi pas një vit shumë sfidues, kemi pas shumë vështirësi, por e vlerësoj se ka qenë një vit i suksesshëm dhe me rezultate të prekshme. Them ka qenë një vit shumë sfidues sepse vetëm në vitin 2025, përmbaruesi i ka marr 3 milionë e 500 mijë euro. 3 milionë e 500 mijë euro janë diku 60% e buxhetit të investimeve kapitale, mirëpo nuk janë marr këto të holla të gjitha nga investimet kapitale, janë marrë prej të gjitha kategorive: nga mallra dhe shërbim; subvencionet dhe transfere, janë marrë edhe nga komunalit dhe kemi pas shumë vështirësi. Këto vështirësi janë paraqitur kryesisht në këtë fundvit, kur na është ndërpre energjia elektrike e ndriçimit publik në mungesë të mjeteve për të paguar faturat, megjithatë ia kemi dalë me një kompromis. I patëm në realitet 350.000 euro të hyra të tejkaluara, se ne kemi pas tavanin e të hyrave vetanake deri sa mund të inaksojmë të hyra. Ato të hyra që tejkalohen më tepër se ato që i kemi planifikuar, atëherë u dasht me e marrë një vendim në Kuvendin e Komunës, me e dërgu në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal e më në fund me e nënshkru edhe ministri i Financave e me na lejue qato mjete me i përdorë. Fati e deshti që shpëtuam pa i marrë edhe këto përmbaruesi. Me ato mjete i kemi paguar faturat e ndriçimit publik dhe i kemi paguar edhe punëtorët e “Përparimit” për shërbimet që i kanë

kryer. Tash janë duke u bërë kyçjet e ndriçimit publik edhe në fshatra, po besoj se në qytet këto kyçe janë bërë, por kanë mbetë vetëm edhe në fshatra.

Gjatë vitit 2025, pra po i referoj disa të arritura, kemi ndërtuar shkollën “Mustafë Venhari”, një shkollë që vërtetë është e kompletuar me të gjitha, kemi hapur çerdhe për fëmijë në fshatin Shtitaricë dhe Stanoc të Epërm, dy me bazë në komunitet. Është një formë ligjore e hapjes së çerdheve me bazë në komunitet, dhe e kemi shfrytëzuar atë mundësi. I kemi blerë 56 tabela të mençura dhe i kemi dërguar nëpër shkolla të qytetit. Besoj se në vitin e ardhshëm do t’i pajisim të gjitha shkollat me tabela të mençura si dhe do t’i trajnojmë mësimmshënësit në përdorimin e tyre, sepse ka shumë aplikacione, ka shumë opsione dhe do të kijohen mundësi që të gjitha lëndët mësimore të zhvillohen përmes tabelave të mençura.

Për studentët kemi ndarë bursa. Vlera e bursave ka qenë më e lartë se ato që i ndanë Universiteti i Prishtinës. I kemi ndarë 70 bursa për studentët që studiojnë në Kosovë në vlerë prej 6000 euro për person, 15 bursa për studentë që studiojnë jashtë vendit në vlerë prej 800 euro dhe 15 bursa për studentë që studiojnë në vendet e BE në vlerë prej 1000 euro.

Përpos këtyre, jemi komuna e vetme që kemi një marrëveshje bashkëfinancimi me CITY College, Kampusi i Universitetit të York Europe në Selanik, Greqi. Ky është kampus i Mbretërisë së Bashkuar në Greqi dhe këtu kemi ndarë 10 bursa kryesisht në Shkenca Kompjuterike, Teknologji të Informimit, në fushën e Komunikimit, në Programim, Inteligjence Artificiale dhe në Psikologji Klinike.

Gjithashtu kemi subvencionuar të rinjtë që kanë ndjekur trajnimet në fushën e zhvillimit Softuerik në Speex Education. I kemi subvencionuar të gjithë të rinjtë pa limit, pa kufi, kushdo që ka shprehur interesim.

Subvencionimi është bërë edhe për kurset e Gjuhës Gjermane dhe atë Frenge në Speex Education. Në vitin 2025 janë gjithsej 647 përfitues në shumën e ndarë prej 85.190 euro, në këto që ne i quajmë “ Shkathhtësi të Buta”. Shumë prej këtyre të rinjëve dhe të rejave e kanë gjetur veten në tregun e punës, veçanërisht ata që i kanë kryer kurset e Programimit dhe të Gjuhës Gjermane.

Diakonie Training Center në Mitrovicë është Shkolla Gjermane e trajnimeve, e zanateve. Këtu i kemi subvencionuar 10 profile profesionale me të cilat të rinjtë mundën me e gjetë veten. Në vitin 2025 kanë qenë përfitues 22 studentë të shumës prej 5.260 euro. T’ju them të drejtën në këto profile nuk jam i kënaqur me pjesëmarrje. Unë mendoj se duhet të ndalet trendi i studimeve në Shkencat Sociale, dhe duhet të shpërndahen kryesisht në Shkencat Teknike, në Shkencat e Informimit dhe Komunikimit, në Shkencën e Arkitekturës dhe në zanatet e ndryshme.

Kemi pajisur kabinete moderne të kimisë, fizikës dhe biologjisë në SHMU2.

Është inauguruar qendra e Arsimit dhe Edukimit të të rinjve dhe të rriturve e cila vjen si bashkëpunim i Komunës së Vushtrrisë me OJQ “ Hareja” dhe me organizatën Gjermane DVV.

Komuna e Vushtrrisë ka mbështetur të rinjtë edhe duke mbuluar biletat jashtë vendi për aktivitete të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, pjesëmarrje në ekspozita. Diku në vitin 2025 janë mbështetur 28 nxënës me vlerën prej 12.250 euro.

Është bërë mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Në vitin 2025 janë mbështetur 77 nxënës me shumën prej 39.000 euro.

Në Urbanizëm kemi zhvilluar shumë projekte, por edhe një numër i madh i tyre na kanë mbetur të papërfunduara pikërisht për shkak të përmbaruesit i cili na ka marrë shumë mjete. Kështu ka mbetur i papërfunduar sheshi “Adem Jashari” i cili do punohet deri te Galeria, megjithatë pjesa kryesore e Parkingut Nëntokësor me një pjesë të madhe janë përfunduar dhe janë në funksion.

Gjithashtu po punohet në ndërtimin e Tregut të Gjellbër në Vushtrri. Na ka mbetur për vitin e ardhshëm edhe një pjesë e tregut për t’u finalizuar. Ky treg parashihet të jetë me parking nëntokësor dhe besoj se do t’i plotësoj të gjitha standardet e një tregu, e që po bëhet tani një vijë e mirë e qendrës së qytetit deri te tregu i Gjellbër.

Parkun e qytetit veç e keni parë se është në finalizim dhe qendra e qytetit do të shndërrohet në një qendër që do të jetë në shfrytëzim të qytetarëve.

Është bërë renovimi i banesave kolektive, më tepër një projekt human. Vërtetë kanë qenë në gjendje shumë të rëndë të banimit një pjesë e qytetarëve të qytetit tonë, tashmë veç e keni parë që e ka marrë një pamje krejt tjetër. Ato banesa janë renovuar sipas standardeve. Do të vazhdojmë me renovimin e të gjitha banesave tjera që i kemi në projekt.

Kemi bërë transformimin e rrugës “Pandeli Sotiri”. Është ndërtuar një rrugë, edhe pse për një periudhë kohore qytetarët dhe ato biznese i kemi penguar por tani është kompletuar ajo rrugë me të gjitha kushtet e një rruge me standarde.

Gjithashtu edhe rrugën “Lumni Surdulli” e kemi zgjeruar dhe është ndërtuar sipas standardit me trotuar për këmbësorë dhe shtigje për biçikleta. Është dashur të bëhen shumë rrëtime të mureve të uzurpuar por janë prekë edhe pronat që nuk kanë pas uzurpim. I falënderoj të gjithë qytetarët e asaj pjese që kanë pasur mirëkuptim dhe me lehtësi e kemi ekzekutuar projektin.

Kemi punuar edhe në riasfaltimin e rrugës kryesore që lidhë fshatrat Dumnicë e Epërme Dumnicë e Llugës dhe Dumnicë e Poshtme në gjatësi 10 km. Ndërtimi i rrugës “Drenica” që e lidhë pjesën prej Urës së Lumit Silnica në drejtim të Novolanit, është punuar me standarde, ka qenë në gjendje jo të mirë.

Ndërkaq asfaltimi i rrugës Akrashticë – Balincë, është i papërfunduar por është afër dhe është punuar shumë.

Edhe asfaltimi i rrugës për në fshatin Skoçan është duke u punuar. Kam parë shumë qytetarë që kanë komentuar në rrjetet sociale se pse është ndërtuar kjo rrugë, kur atje nuk ka banorë. Ta dinë

të gjithë se nëse nuk e zhvillojmë zonën e Shalës, ato mija hektarë që kanë mbetur djerrina dhe t'i shndërrojmë në agroturizëm, nuk do të ketë zhvillim ekonomik as në qytetin e Vushtrrisë. I kemi këto dy zona, zona e Shalës dhe Zona e Qyqavicës, prandaj kemi investuar. Nuk kemi investuar për zgjedhjen e problemeve për dy-tre qytetarë që janë atje, por kemi investuar për shtrirjen e investimeve, në mënyrë që t'ju hapet rrugë investimeve direkte në ato zona.

Janë asfaltuar rruga kryesore në Lumadh, Segmente të rrugës "Raif Dushi" dhe "Batalioni i Parë", rruga "Jeton Tërstena", rruga "Atëdhetari". Janë rikonstruktuar rrugët "Marlin Barleti", "Hoxhë Kadri Prishtina" dhe "Sali Zeka".

Te Shërbimet Publike e kemi bërë ndërtimin e disa parqeve. Fillimisht parkut të ri në hapsirat e ish-parkingut të taksistëve, përballë Shtëpisë së Kulturës. Vërtetë ka pasur nevojë për një intervenim të tillë, e unë besoj se të gjithë qytetarët që kalojnë atje janë të kënaqur.

Pastaj një park rekreativ në Lumadh, i cili përmban kënd të lojërave, shtigje për ecje, ndriçim, ulëse, hapësira të gjelbra e drunjë dekorativ.

Sa i përket Parkut rekreativ të Ura e Gurit, këtu kemi një ngecje. Na janë ndaluar punimet për shkak se Ura e Gurit është nën mbrojtjen e veçantë, në mënyrë të paarsyeshme, kemi biseduar me të gjitha institucionet por ende nuk e kemi zgjidhur vetë problemin. Ka mbetur edhe një pjesë e sheshit e papërfunduar, por besoj se do të përfundohet.

Në kuadër të Shërbimeve Publike është bërë edhe ndërtimi i Shtëpisë së Komunitetit në fshatin Oshlan. Kemi rregulluar çezmën në fshatin Vërnice.

Komuna e Vushtrrisë ka arritur një marrëveshje për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza duke ndaluar ndotjen e lumenjve. E kemi nënshkruar marrëveshjen në mes komunave: Mitrovicë, Vushtri dhe Kompanisë Regjionale të Ujësjellsit, me Bankën Europiane për rindërtim dhe zhvillim në vlerën prej 39 milionë euro. Ideja është që ujërat që derdhen në Vushtri dhe në lumin Silnica, të gjitha të pastrohen në këtë impiant të trajtimit. Deri më tani kanë pasur pak problem me prona, por është zgjidhur edhe ai problem dhe besoj se gjatë vitit 2026 do të shihen punët në teren.

Janë shtruar trotuare në Dobërllukë, Reznik, Stroc, Maxhunaj. Është bërë shtrirja e rrjetit të kanalizimit në Sfaraçak, e rrjetit të ujësjellësit në lagjen e Mazhiqëve, kycja e rrjetit të ujësjellësit në Dumnicë. E kemi shtruar me kubëza rrugën "Kërqova".

Gjithashtu kemi asfaltuar rrugën që lidhë fshatërat Bukosh, Taraxhë, Liqej me Vushtrrinë. Komuna ka ndërtuar edhe Urën e re në Dobërllukë. Edhe kjo urë ka pas nevojë të ndërtohet sepse ka qenë në gjendje shumë të rëndë, dhe i ka shpëtuar bujqit e asaj ane.

Sa i përket Shëndetësisë, e kemi blerë një aparat Mamograf për QKMF në Vushtri për diagnostikim të kancerit të gjirit në fazë të hershme. Është punuar edhe në ndërtimin e zyrave të reja të administratës së QKMF-së.

Kur flasim për Mbrojtje dhe Shpëtim, jo vetëm viti 2025 por pothuajse tërë mandati na ka shkuar duke bërë pastrimin e lumenjve, përroskave. Kështu që Drejtoria për Emergjencë e ka bërë një punë të shkëlqyeshme në këtë drejtim. Nuk është ndalur asnjëherë gjatë gjithë këtij mandati dhe rezultatin e keni parë vetëm gjatë të reshurave të fundit që i morën shumë qytete të Kosovës, Vushtrria sikur kishte lartësinë mbidetare përmbi to dhe nuk u prek nga këto reshje.

Tek Bujqësia, për herë të parë i kemi subvencionuar shpenzimet e ujitjes së tokave që janë nën sistemin e ujitjes me 50 %. Për herë të parë janë subvencionuar edhe fermerët nga 5 cent për litër qumështi.

Kemi premtuar subvencionimin e fermerëve me 5 euro për çdo koshere të bletëve, deleve, dhive dhe 100 euro për kokë të buallicës. Këtyre u kemi mbetë borxh, dy këste nuk i kemi paguar. Edhe kjo lidhet me kontratën kolektive të mjeteve që na janë marrë nga përmbaruesi. Por për vitin 2026 janë planifikuar këto mjete dhe do t'i shlyejmë të gjitha këto borxhe.

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është restauruar objekti i ish Arkivit. Ende nuk është vendosur se për çka do ta shfrytëzojmë, por do ta bëjmë një diskutim brenda qeverisë por edhe një diskutim me qytetarët e të shohim për çka do ta dedikojmë.

Është bërë ndërtimi i Lapidarit të Batalionit të Parë të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës në fshatin Gllavatin. Gjithashtu renovimi i pllakës përkujtimore për martirët nga fshatrat Reznik, Vërnice dhe Shalle.

Edhe te Kultura është bërë një punë e madhe. Janë mbajtur shtatë Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për herë të parë në qytetin e Vushtrrisë, ku kanë marrë pjesë akademikë nga të gjitha trojet shqiptare. Janë mbajtur shumë festivale, është organizuar edhe Festivali i Diasporës, Festivali i Poezisë, Festivali i Filmit të metrazhit të shkurtë, shumë koncerte, shumë aktivitete. Po ashtu sa i përket kulturës kemi sponsorizuar incizimin e këngëve të qytetit të Vushtrrisë dhe i kemi sponsorizuar të gjitha monografitë e autorëve vushtrrias, të cilët i falënderoj për punën e tyre të palodhshme. Veçanërisht falënderoj Shoqatën e Veteranëve të Arsimit, e kemi të pranishëm këtu edhe Kryetarin e Shoqatës prof. Halil Mulakun, më të gjithë ata profesorë që janë duke punuar pa u lodhur.

Mund të ju them me krenari që ne si Komunë kemi një administratë shumë funksionale dhe nuk e di që një qytetar e ka kërkuar një shërbim në administratë dhe ka pritur më shumë se pak minuta. Është rregulluar edhe infrastruktura e pritjes në hollin e zyrave të administratës dhe po ashtu për bashkatdhetarët kemi hapur sportele të veçanta. Meqenëse është fundi i vitit dhe kanë ardhë shumë mërgimtarë, dëshiroj t'ju uroj mirëseardhje dhe qëndrim të mirë në familje, në vendlindjen e tyre dhe vendlindjen tonë të përbashkët si dhe i falënderoj për gjithë kontributin që e kanë dhënë për familjet tona dhe për kohën në përgjithësi.

Sa i përket transparencës buxhetore, Komuna e Vushtrrisë është vlerësuar nga Instituti GAP me 100 pikë prej 100 pikëve, pra jemi të parët në nivel vendi për transparencë buxhetore.

Tani po presim komentet dhe fjalën po e kaloj tek ju. Ka edhe shumë punë dhe aktivitete që janë kryer, por mendova që në mënyrë telegrafike t'ju njoftoj dhe t'i përmend ato që janë më kryesore. Ju falënderoj shumë e tash fjala është e juaja!

Murteza Dallku, qytetar i Vushtrrisë, ju përgëzoj për punën që keni bërë deri më tash se vërtetë keni kontribuar për qytetin e Vushtrrisë. Njëherit i përshëndes të pranishmit. Një gjë më ka rënë në sy, sipas mendimit të qytetarëve është një prioritet i nevojshëm që para lufte kemi pas stacion të autobusëve e tani që sa pas lufte nuk kemi stacion. Po shihet se tollovia me autobus çdo 100 metra ndalen me marrë udhëtarë. Nuk jam kundër asaj për me ju shërbyer qytetarëve, por po ka mjaft rreziqe për këmbësor dhe për vetura. Kontributi i juaj do të ishte shumë i madh nëse mund të bënit diçka për një stacion të autobusëve. Faleminderit!

Ismail Haziri, kryetar i lagjes urbane “Dardania” në Vushtrri, i përkrahim të gjitha punët që ju i keni kryer, por unë e kam dërguar një kërkesë Kryetarit, bordit të drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk dua t'i përmend të gjitha ato se janë shumë, por një prej kërkesave është ajo e laboratorit për analiza që gjendet në hyrje të Vushtrrisë në rrugën “Dëshmorët e Kombit”. Aty kanë qenë gjithë, edhe ju keni premtuar që sa më parë do të aktivizohet, me beso që për çdo ditë vijnë dhe pyesin çka u bë me të, që 4 vite që nuk punon. Ju kisha lutë që në këtë drejtim të punoni me seriozitet dhe të zgjidhet kjo çështje, se probleme ka plot, të arsyeshme e të paarsyeshme, sepse këto nuk ndalen kurrë. Edhe një herë kërkoj nga ju Zoti Kryetar që këtë çështje ta rregulloni. Faleminderit!

Gazmend Selmani, nga fshati Druar, sa i përket subvencionit të qumështit, unë dëgjova një përgjigje nga ju se kemi filluar për herë të parë, por pagesat neve nuk na janë bërë në vitin 2024 dhe 2025. A pritet të rritet subvencionimi i qumështit ashtu siç keni premtuar në fushatë. Edhe një pyetje të dytë. Unë jetoj në lagjen Geci në fshatin Druar. Na nuk kemi ujë të pijes. Dy vite a tri i ka që keni thënë se problemi ka mbetë te vendosja e pompave në Mihaliq. Ne sot nuk kemi ujë. Për mendimin tim kjo është e papranueshme sepse është diçka elementare për njerëzit. Çdo punë që e ke realizuar të përgëzoj, por kur është diçka prioritare edhe ju duhet të keni këtë me prioritet sepse nuk është diçka bënë apo nuk bënë pa të, e unë mendoj se nuk bon pa të se është ujë i pijshëm sepse nuk ka ujë në lagjen Geci. Ju lutem t'i jepni prioritet kësaj çështjeje. Ju faleminderit!

Halil Mulaku, kryetar i Shoqatës së Veteranëve të Arsimit, së pari ju përshëndes për këtë ndërmarrje me qytetarë që është shumë me rëndësi. Dëgjuam ekspozenë tuaj me shumë vëmendje. Po ashtu, që është bërë punë e madhe nga ju dhe stafi juaj që gjenden këtu. Nga raporti që e dëgjuam nga ju, jam i bindur që ju nuk i thatë të gjitha ato që i keni punuar, sepse keni punuar shumë me tepër se sa ato që i përmendët. Ju falënderoj shumë nga zemra. Njëherit e kisha shprehë një dëshirë rreth rrugës “Ferit Mulaku” në Vushtrri pranë shkollës “Mustafë Venhari”, ku çdoherë fekalet dalin mbi tokë. Nuk rrihet nga kundërmimi i erës e sidomos kur bie shi. Me gjasë janë

shtuar banorët, banesa shumë e kanalizimi i hershëm nuk po e përballon. Ju lutëm të intervenohet, ndonëse disa ditë përpara është intervenuar por si duket nuk është bërë zgjedhja e duhur. Ju falënderoj!

Në këtë takim pjesëmarrës ishin 22 qytetarë.

Takimi ka përfunduar në ora 12:30.

Procesmbajtëse:

Blerina Neziri

BG mp.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Lista e pjesëmarrësve


Takimi i dytë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 26.12.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Isuf Jasari		VUSHTRRI
2	Benjamin Shala		Akroshtec
3	Hyrie Uka Hoxha		Vushtri
4	Medinia Bunjaku		Vushtri
5	Miley Ferozi		PESTOVË
6	IZO MURRI		Vushtrri
7	Halil Mula		Vushtrri
8	Murtesa Dallku		Vushtrri
9	Samir Hoxha		Lu "D" and ar. Vu.
10	Dardan Hoxha		Vushtri
11	BASHKIM SADIKU		VUSHTRRI
12	Sami Bishim		Vushtrri
13	Ebren Lufca		Vushtrri
14	FAZLI KASHICA		VUSHTRRI
15	SELIM KASUMI		PESTOVË



Takimi i dytë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”

Datë: 26.12.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	GAZMEND SELMANI	Gh	DRUAR
17	HALIT	HYSENI	GLLOVOTIN
18	ISA SULE	Isa	VERRUC
19	BILAL OSMAN	Bilal	KURDASHI
20	ALBANEZ TEHIQ	Alban	
21	QENDROSA RASHICA	Qendro	VUSHTRRI
22	KLODIAN RASHICA	Klod	VUSHTRRI
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			